



	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË	
REKTORATI			
Nr. / Br. / No.	1802	Nr. i faq/ Br. str / No. pg	13
Data / Datum / Date:	17.07.2023	Pejë / Poë	

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Adresa: Rruga e UÇK-së 30000 Pejë, Republika e Kosovës, Tel: + 383 039 432 270, info@unhz.eu

UNIVERSITET "HAXHI ZEKA" PEJË
QENDRA E EKSELENCËS
PLANIFIKIMI VJETOR I MODULEVE TË TRAJNIMEVE

Historiku i shkurt i Universitetit “Haxhi Zeka”

Njëra ndër karakteristikat të cilat Pejën e bëjnë me më vlerë, është fakti se ajo është ndër qendrat e para në Kosovë e më gjerë në fushën e ofrimit të arsimit të lartë. Ish Shkolla e Lartë Komerciale, e transformuar pas vitit 1999 në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në Biznes (FSHAB), është themeluar që në vitin 1960, duke kontribuar në krijimin dhe promovimin e një kulture akademike. Që nga ajo kohë e në kontinuitet, për dekada me radhë, në këtë institucion janë kualifikuar dhjetëra mijëra ekonomistë me profile specifike të kontabilitetit, komercialistit dhe turizmit për tregun e punës në Kosovë dhe rajon.

Më 30 maj 2013, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 17 paragrafi 1 i Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037, miratoj Statutin e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë.

Fakultetet e UHZ, zyrtarisht filluan të zbatojnë programet e tyre të studimit në përputhje me parimet e Bolonjës, sipas plan – programeve të akredituara, nga viti akademik 20012/13. Me vizionin që ka UHZ synon të jetë lider me kurrikulë studimore të integruar dhe bashkëkohore në harmoni me kërkesat e tregut në fushën e biznesit, agrobiznesit, mjedisit, turizmit, arteve, drejtësisë, aplikimit të teknologjisë së informacionit dhe në fusha të tjera të ndërlidhura.

Universiteti “Haxhi Zeka” është një institucion publik i arsimit të lartë që merret me arsimin e lartë në të tre ciklet e studimit dhe punën kërkimore-shkencore me synime që përfshijnë përmirësimin e njohurive, mendimit dhe arsimit, aktiviteve arsimore, artistike, kulturore, sociale dhe zhvillimin ekonomik, promovimin e shoqërisë demokratike dhe arritjen e standardeve më të larta të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

QENDRA E EKSELENCËS NË UNIVERSITETIN "HAXHI ZEKA" PEJË PLANI I ZHVILLIMIT TE TRAJNIMEVE 2023-2024

Qendra e Ekselencës është themeluar në bazë vendimit të Këshillit Drejtues të UHZ-së Peje me nr. prot: 412 dt: 03.03.2022, e cila ka për qëllim të mbështes stafin akademik në zhvillimin e tij profesional.

Qendra e Ekselencës (në tekstin e mëtejshëm QE) ka për qëllim të ndihmojë Universitetin e "Haxhi Zeka" në Pejë duke ofruar trajnime stafit akademik të rregullt për avancimin e kapaciteteve akademike dhe zhvillimin e sistemeve mësimore të cilat promovojnë mësimdhënien më efektive dhe më cilësore, në funksion të transformimit të UHZ-së në një universitet konkurrent me universitetet më të mira, rrjedhimisht një mësimdhënie me cilësore për studentet e UHZ-se sipas standardeve më të mira në Rajon dhe me gjere .

QENDRA PËR EKSELENCE u krijua për të mbështetur stafin akademik drejt rritjes së aftësive profesionale dhe drejt procesit të profilizimit përmes trajnimeve specifike për metodologjitë e avancuara të mësimdhënies dhe të nxënit. Në të ardhmen e afërt, HZU synon ta pasurojë këtë qendër me konceptet e ekselencës dixhitale. Fokusi i kësaj qendre është i orientuar drejt inovacionit, kërkimit, zhvillimit dhe trajnimit me trajnerë vendas dhe ndërkombëtarë

1. Misioni i QE-së është rritja e efektivitetit dhe përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në UHZ nëpërmjet:
 - 1.1. Organizimit dhe realizimit të aktivitete që kontribuojnë dhe sigurojnë avancimin e aftësive dhe kompetencave të stafit akademik;
 - 1.2. Promovimit të kulturës së përsosmërisë akademike nëpërmjet zbatimit të standardeve dhe praktikave më të mira në mësimdhënie;
 - 1.3. Ofrimit të shërbimeve në fushën e përsosmërisë në mësimdhënie (zhvillimin e kurrikulave, përgatitjen e materialeve mësimore, angazhimin dhe vlerësimin permanent të studentëve, aplikimin e metodave hibride në mësimdhënie, mësimin e bazuar në platformat elektronike etj.
 - 1.4. Mbështetjes së Fakulteteve dhe stafit akademik në lidhje me zbatimin e praktikave inovative dhe të dëshmuara në mësimdhënie, mentorim dhe vlerësim të studentëve;
 - 1.5. Promovimit dhe ofrimit të shërbimeve në lidhje me zbatimin e standardeve të etikës në mësimdhënie.

Duke u bazuar në qëllimin e Rregullores, Sipas nenit 4 Qendra e Ekselencës (QE) zhvillon këto aktivitete:

2. Hulumtimin dhe identifikimin e nevojave për trajnime në fushën e mësimdhënies dhe mësim nxënies;
 - 2.1. Organizimin e trajnimeve për metodat bashkëkohore të mësimdhënies për stafin akademik të rregullt;
 - 2.2. Identifikimi dhe prioriteti i sfidave, nevojave dhe mundësive që UHZ-ja t'i adresojë nëpërmjet trajnimeve dhe programeve të ofruara në QE;
 - 2.3. Zhvillimi dhe realizimi i trajnimeve që do të plotësojnë nevojat e stafit akademik në UHZ dhe institucioneve tjera të Arsimit të Lartë;
 - 2.4. Identifikimi dhe zhvillimi i formave alternative të mbështetjes financiare për QE dhe inkurajimi i donatorëve për të investuar në përmirësimin e mësimdhënies në UHZ;
 - 2.5. Zhvillimi i procedurave për monitorimin dhe raportimin e rezultateve.

Sipas planit strategjik (2023 -2026) Qendra e Ekselencës përbën një strukturë të përbashkët brenda UHZ-së që ofron praktika të mira akademike, kërkime, mbështetje dhe përkrahje profesionale. Qendra po ashtu do të hartojë programe për zhvillim profesional varësisht nga nevojat e njësisë akademike si dhe programe individuale të zhvillimit në karriere të zhvilluara për stafin akademik. Po ashtu sipas planit strategjik të UHZ zhvillimi dhe funksionalizimi i plote i qendrës së ekselencës është një nga prioritetet primare .

Sipas nenit 13 të rregullores për QE ; Plani i trajnimeve për vitin vijues hartohet nga këshilli i QE – së në bazë të nevojave të njësive akademike dhe specifikave të tyre dhe është obligativ për të gjithë stafin akademik;

Plani i Trajnimeve për Stafin Akademik 2023-2024

Trajnimet	Trajnerët	Koha e realizimit	Datat e realizimi	Pjesëmarrës të synuar Stafi Akademik
Structured Internships in Agriculture:	Iowa University -Project	Qershor 2023	15 qershor	20 persona , Staf akademik UHZ
Pedagogjia e Mësimdhënies - Klasat me mësimin në qendër Pedagogy of Teaching Introduction to Learning-Centered Classes	Iowa University -Project Janice Wiersema, PhD (Associate Teaching Professor) Curt Youngs, PhD (Morrill Professor)	Qershor 2023	29-30 qershor	15 persona , Staf akademik UHZ
Hartimi i plan-programit semestral (syllabus-Taksonomia e Blumit)	Prof.Ass.Vjosa Hajdari-Fullbright Scholar Prof.Asoc.Theranda Beqiri	Shtator/Tetor 2023		2 gr/10-15 prs
Hartimi i plan-programit semestral (syllabus me specifikat e arteve)	Prof. asoc. mr. Mimoza Pajaziti Drançolli	Shtator/Tetor 2023		1 gr/10-15 prs
Metodat e Hulumtimeve dhe Analiza e të Dhënave Primare dhe Sekondare në SPSS	Prof .Ass Vlora Berisha - Fullbright Scholar Prof. Ass Fisnik Morina- Post doc Malta	Tetor Nëntor 2023		2gr/10 -15 prs
Trajnim Lidhur me Metodat e Komunikimit	Prof. Ass Thëllëza Latifi Prof. Ass Mersiha Kalac	Nëntor Dhjetor 2023		2 gr/10-15 prs
Mësimi i Vetëdrejtuar në Arsimin e Lartë Self-directed learning in Higher Education (SDL)	Prof. Ass Enkeleda Lulaj	Nëntor Dhjetor 2023		2 gr/10-15 prs

QENDRA E EKSELENCËS - Modulet e trajnimeve për stafin akademik të UHZ

Moduli Mësimdhënësi/t Trajneri/ët	-	Structured Internships in Agriculture- Puna praktike e strukturuar
		Iowa University -Project Christen Burgett, PhD (Associate Teaching Professor) Curt Youngs, PhD (Morrill Professor)
Pjesëmarrësit e synuar		Stafi Akademik i Universitetit Haxhi Zeka

Përshkrimi i shkurtër

Ky trajnim ka të bëjë me Punën praktike për student . Si të strukturoren modulet e punës praktikë, si të zhvillohet mësimi i studentëve. objektivat për praktikë, mekanizmat për vlerësime formuese dhe përmbledhëse etj. Trajnimi synon stafin kryesor të mësimdhënies dhe personelin universitar që do të përfshihet në ngritjen, menaxhimin dhe vlerësimin e mësimi praktik për studente

Qëllimi i mësimi praktik

Është që të shpjegoj dhe kuptoj strukturën dhe funksionin e një kompanie, jofitimprurëse, qeveritare, etj. Mësimin Praktikë me ndikim të lartë, i cili ofron mësim praktik dhe aktiv për studentet si dhe që promovon të mësuarit e duhur për tregun e punës .

1. Kërkohej përpjekje të konsiderueshme të studentëve
2. Ndërtojnë marrëdhënie kuptimplote
- ♣ 3. Jepet mundësi studentëve që të ndër veprojnë me njerëz të ndryshëm nga ata
- ♣ 4. Ofrohen komente të shpeshta për performancën e tyre
- ♣ 5. Studentëve u ofrohen mundësi të shumta për të zbatuar atë që mësojnë në mjedise të ndryshme
- ♣ 6. Ndihmojnë studentet që të kuptojë më mirë veten në raport me të tjerët

o Ndhmon studentët në zgjedhjen e karrierës së ardhshme

Rezultatet e pritura dhe Pse është i rëndësishëm Mësimi Praktik?

o Përfitimet për kompaninë

o Përfitimet për studentët

o Përfitimet për universitetin

Puna praktike do t'ju mundësoj studentëve të arrijnë disa nga këto objektiva:

- Të testojnë veten dhe interesin e tyre për një karrierë të caktuar;
- Të aplikojnë teorinë në situata reale të punës;
- Të zhvillojnë shkathtësi të reja apo përmirësojnë shkathtësitë ekzistuese që mund të shfrytëzojnë për të bërë karrierë;
- Të rrisin shanset për të bërë karrierë në fushën e përzgjedhur;

Moduli		Pedagogjia e Mësimdhënies -Klasat me mësimin në qendër
Mësimdhënësi/t	-	Iowa University -Project
Trajneri/ët		Janice Wiersema, PhD (Associate Teaching Professor) Curt Youngs, PhD (Morrill Professor)
Pjesëmarrësit e synuar		Stafi Akademik i Universitetit Haxhi Zeka

Përshkrimi i shkurtër

Moduli 'Pedagogjia e Mësimdhënies -Klasat me mësimin në qendër'

Profesionistët e arsimit të lartë janë shumë të kualifikuar në fusha të veçanta të disiplinës, por pak prej tyre kanë pasur trajnime formale lidhur me teorinë e të nxënësve dhe të mësimdhënies. Edhe më pak staf akademik ka studiuar trurin aktual, ose ka hulumtuar aplikimet dhe implikimet e mundshme të atij kërkimi. Përmes këtij trajnimi, ju keni mundësinë të përjetoni dhe diskutoni teorinë e të mësuarit dhe të mësimdhënies dhe kërkimin e trurit. Ju do të merrni ndihmë në zbatimin e kuptimeve tuaja të reja në situata ku ju udhëhiqni të mësuarit. Takimet tuaja, klasat, sesionet orientuese ose çdo situatë tjetër mësimore për të cilën ju jeni përgjegjës ku mund të planifikoni qëllimisht për ta bërë udhëheqjen tuaj edhe më efektive për t'u përmirësuar të mësuarit.

- informacion rreth teorive specifike të të nxënësve dhe të mësimdhënies;

- ide praktike për të përmirësuar të nxënit;
- strategjitë për të siguruar përpunimin e qëllimshëm mendor nga studentet ;
- strategji për të promovuar nivele më të larta të të menduarit dhe arsytimit nga studentët;
- strategji për të promovuar arritje më të larta të nxënësve dhe qëndrueshmëri te arritjeve;
- mundësitë për të bashkëvepruar me kolegët tuaj rreth mësimit dhe mësimdhënies;
- mundësitë për të zhvilluar plane për t'i ndihmuar studentët të mësojnë; dhe
- mundësitë për t'u përfshirë në përpunim mendor të qëllimshëm që do të inkurajojë dhe mbështesë mësim të vazhdueshëm

Rezultatet e synuara të të nxënit :

- Shqyrtoni bindjet rreth të nxënit.
- Diskutoni teoritë e zgjedhura të të mësuarit dhe implikimet për të ndihmuar të tjerët të mësojnë.
- Përjetoni strategji dhe aktivitete të përqendruara te mësimi.
- Planifikoni me qëllim përdorimin e aktiviteteve të përqendruara te mësimi me nxënësit.
- Reflektoni qëllimisht rreth mundësive të të mësuarit për të përmirësuar të nxënit.
- Përjetimi dhe ndërtimi komunitetit në një mjedis të sigurt

Moduli	Hartimi i plan-programit semestral (syllabus- Taksonomia e Blumit)
Mësimdhënësi/t Trajneri/ët	
	Prof.Ass.Vjosa Hajdari (Fullbright Scholar)
	Prof.Asoc.Theranda Beqiri (Tempus Scholar)
Pjesëmarrësit e synuar	Stafi Akademik i Universitetit Haxhi Zeka

Përshkrimi i shkurtër

Moduli "*Hartimi i syllabusit*" sipas Taksonomisë së Blumit, ka qëllim të mbështesë stafin akademik për hartimin e syllabuseve, me standardet e kërkuara nga universiteti, që t'i përshkruajnë, shqyrtojnë, rishikojnë syllabuset e tyre për lëndët përkatëse. Procesi i hartimit të një syllabusi është një mundësi e mirë për mësimdhënësin që të reflektojë, në përputhje me standardet e kohës, duke e shtyrë atë të marrë në konsideratë metodologjinë e mësimdhënies, rëndësinë e lëndës, temat të cilat do të trajtohen, për çfarë kursi bëhet fjalë, pse mësohet lënda, çfarë do të kërkohej që studentët të jenë të suksesshëm në kurs etj.

Qëllimi i modulit

Ky modul do të pasqyrojë perspektivën, për një syllabus adekuat ku përfshihen të gjitha elementet e nevojshme duke filluar nga përshkrimi i lëndës, qëllimi, rezultatet, aktivitetet, mësim nxënien metodologjinë dhe procesin e vlerësimit të studentëve.

Përmes këtij moduli do të elaborohet rëndësia e qëllimit tek Hartimi i Syllabusit duke ju përgjigje në këto dy pyetje: Cili është qëllimi i kësaj lënde mësimore? Si dhe Çfarë po përpiqet të arrihet përmes kësaj lënde mësimore?

Rezultatet e të nxënit

Moduli trajtohet duke përdor Taksonomia e Bloom-it duke sqaruar që rezultati i të nxënit ka për qëllim që të :

- Përcakton elementet themelore të një syllabusi sipas standardeve të kërkuara;
- Përfshin në secilën komponentë të syllabusit elementet e kërkuara;
- Harton syllabusin e lëndës/kursit sipas kritereve të përcaktuara.

Metodologjia e mësimdhënies

Moduli trajtohet duke përdorur metodologji dhe teknika bashkëkohore të mësimdhënies, përmes mësimit interaktiv, diskutimeve, demonstrimeve, prezantimeve si dhe duke përdorur forma të ndryshme të punës, si individuale, dyshe, punës në grupe, etj.

Moduli		Metodat e Hulumtimeve dhe Analiza e të Dhënave Primare dhe Sekondare në SPSS: Procesi i Projektimit të Pyetësorëve dhe Importimi i Pyetjeve në SPSS
Mësimdhënësi/t	–	Prof.Ass Vlora Berisha -Fullbright Scholar Post-doc Prof. Ass Fisnik Morina- Post doc
Trajneri/ët		
Pjesëmarrësit e synuar		Stafi Akademik i Universitetit Haxhi Zeka

Përshkrimi i shkurtër

Trajnimi bazuar në metodat e hulumtimeve dhe analizën e të dhënave primare dhe sekondare në SPSS ka si qëllim përmirësimin e aftësive të nxënësve për të projektuar pyetësorë dhe

importuar pyetje në programin SPSS. Këto metodë ofrojnë një mënyrë të strukturuar dhe efikase për të marrë dhe analizuar të dhëna nëpërmjet pyetësorëve.

Qëllimi i modulit

- Të sigurojë njohuri të hollësishme mbi metodat e hulumtimeve: Trajnimi ofron një kuptim të thellë mbi metodat e hulumtimeve, duke përfshirë identifikimin e qëllimeve të hulumtimit, projektimin e pyetësorëve të efektshme dhe identifikimin e variablave relevante për të mbledhur të dhënat primare dhe sekondare.
- Të zhvillojë aftësitë e projektimit të pyetësorëve: Trajnimi përqendrohet në përcaktimin e tipit të pyetjeve (mbyllur apo hapur), strukturimin e pyetjeve për të siguruar qartësi dhe përgjigje të sakta, dhe identifikimin e attributeve të pyetjeve të mbyllura si opsione të parashtruara.
- Të ndihmojë në importimin e pyetjeve në SPSS: Trajnimi përfshin mësimin e hapat për të importuar pyetjet nga formate të ndryshme (si Excel) në programin SPSS. Kjo përfshin krijimin e variablave për secilën pyetje dhe atributet e tyre, siç janë etiketat e opsioneve të parashtruara.

Rezultatet e të nxënit

- Aftësia për të projektuar pyetësorë të mirë-strukturuar dhe efektive për të mbledhur të dhëna primare.
- Njohuria e nevojshme për të importuar pyetje në SPSS dhe për të përpunuar të dhënat për analizë.
- Aftësia për të përdorur komandat e ndryshme të SPSS për të analizuar të dhënat dhe për të prezantuar rezultatet.
- Analiza te rasteve me të dhëna primare dhe sekondare.

Metodologjia e mësimdhënies:

Ndër qasjet ndërvepruese veçojmë: shpjegimi dhe diskutimet në mes anëtarëve të grupit, shembujt praktik për aplikim në programin SPSS, analizimi i rasteve të ndryshme të hulumtimeve shkencore dhe diskutimet e gjetjeve ekonometrike etj.

Moduli		Rëndësia e Komunikimit ne Mësimdhënie
Mësimdhënësi/t Trajneri/ët	–	Prof. Ass Thëllëza Latifi Prof. Ass Mersiha Kalac

Pjesëmarrësit e synuar	Stafi Akademik i Universitetit Haxhi Zeka
------------------------	---

Rëndësia e Komunikimit ne Mësimdhënie

Profesionalizmi: Puna në grup, mbledhjet, aftësisë e të dëgjuarit, aftësitë verbale, jo-verbale ,dhe rregullat e mirësjelljes

Përshkrimi i shkurtër

Komunikimi ndikon në rritje dhe zhvillim ,synon t'i përgatisë mësimdhënësit për karrierën e tyre profesionale në vendet e punës që po digjitalizohen dhe globalizohen gjithnjë e më shumë. Përmes teknikave ndërvepruese të komunikimit mësimdhënësit fitojnë njohuri dhe shkathtësi të reja të cilat ndikojnë në zhvillim personal, kulturor, krijimin e marrëdhënieve ndër personale, qasjen ,sjelljen dhe aftësitë të tjera si të dëgjuarit, aftësitë verbale dhe jo-verbale, menaxhimi, puna në grup duke përfshirë aspekte të rëndësishme të ndërtimit të ekipit dhe marrëdhënieve konstruktive si formimi, konflikti, normalizimi, performimi etj.

Qëllimi i modulit

Moduli “Rëndësia e komunikimit ne Mësimdhënie ” ka për qëllim t'i zhvillojë mësimdhënësit duke u fokusuar te shkathtësitë e zbatimit të teknikave ndërvepruese të komunikimit. Përmes këtij modulit ,synohet që mësimdhënësit të kuptojnë rëndësinë e punës në grup dhe si mund të kontribuojnë pozitivisht në ecurinë e punës së ekipit, te diskutojnë në mënyrë efektive për planifikimin e takimeve ballë për ballë si dhe ato virtuale duke zbatuar teknikat e të dëgjuarit aktiv ,rëndësinë e komunikimit jo-verbal duke u zhvilluar në mënyrë profesionale drejt arritjes së qëllimeve të përbashkëta.

Rezultatet e të nxënit:

- Të kuptoni rëndësinë e punës në grup në epokën e sotme digjitale, si dhe të shpjegoni se si mund të kontribuoni pozitivisht në ecurinë e punës së ekipit
- Të diskutoni në mënyrë efektive praktikat dhe teknologjitë për planifikimin e takimeve dhe pjesëmarrjen në takimet balle për ballë, si dhe ato virtuale
- Të shpjegoni dhe zbatoni teknikat e të dëgjuarit aktiv
- Të kuptoni se si komunikimi jo-verbal efektiv mund t'ju ndihmojë për të bërë për[ara në karrierën tuaj

- Të përmirësoni avantazhin tuaj konkurrues , duke zhvilluar profesionalizmin dhe duke zbatuar rregullat e mirësjelljes në biznes.

Metodologjia e mësimdhënies:

Ndër qasjet ndërvepruese veçojmë: detyrat krijuese; përdorimi i burimeve njerëzore (ekskursione, ftesë ekspertësh); projektet sociale; përdorimi i materialit të ri (leksione interaktive, materiale video-audio, studenti në rolin e "mësuesit", dialogu duke bërë pyetje); zgjidhja e detyrave (hartat shoqëruese, stuhi mendimesh, analizë rasti, krijimi i një ngjarje dhe performimi, kahoot).

Moduli		Zbërthimi i Artit të Mësimit të Vetëdrejtuar
Mësimdhënësi/t Trajneri/ët	–	Prof.Ass. Enkeleda Lulaj, PhD certifikuar për SDL në North West University (COL), Kanadë.
Pjesëmarrësit e synuar		Stafi Akademik i Universitetit Haxhi Zeka

"Fuqizimi i Profesorëve: Zbërthimi i Artit të Mësimit të Vetëdrejtuar,"

Përshkrimi i shkurtër

Edukimi i sotëm që zhvillohet me shpejtësi, ku studentët kërkojnë autonomi, angazhim dhe aftësi të mësuarit të gjatë gjithë jetës, roli i profesorëve ka tejkalar metodat tradicionale. Ky trajnim ka për qëllim të zhvilloj strategjitë dhe njohuritë që ju duhen për të kultivuar një mjedis të mësimit të dinamik dhe të përqendruar në studentë përmes fuqisë së mësimit të vetëdrejtuar duke kombinuar njohuritë teorike me aplikime praktike, duke ju fuqizuar të drejtoni përpjekjet për të kultivuar një brez studentësh të pavarur, të motivuar dhe të qëndrueshëm.

Qëllimi i modulit

- Zbërthimi i Potencialit të Mësimit të Vetëdrejtuar: Hulumtoni konceptin e mësimit të vetëdrejtuar, rëndësinë e tij në epokën dixhitale të sotme dhe ndikimin e tij të thellë në suksesin akademik dhe rritjen personale të studentëve.
- Nxitja e Autonomisë: Zbuloni strategji inovative për të kultivuar autonomi tek studentët, motivim intrinsik dhe zakonet e mësimit të vetërrotulluar, duke i bërë ata pjesëmarrës aktiv në udhëtimin e tyre arsimor.

- Teknologjia si Mundësi: Përdorni fuqinë e mjeteve digjitalë, platformave arsimore dhe burimeve në internet për të krijuar përvoja të mësimit të përfshirë që përshtaten me stilin dhe preferencat e mësimit të individëve.
- Strategjitë e Vlerësimit dhe Kthimi: Mësoni metoda efektive të vlerësimit që përputhen me mësimin e vetëdrejtuar dhe zhvilloni teknika të plotësuara të kthimit që frymëzojnë përmirësim të vazhdueshëm dhe reflektim.
- Tejkalimi i Sfidave: Adresoni pengesat e zakonshme në zbatimin e mësimit të vetëdrejtuar dhe fitoni zgjidhje praktike për të krijuar një mjedis mësimor të përfshirë, mbështetës dhe stimulues për të gjithë studentët.

Rezultatet e të nxënit

- Përcaktoni mësimin e vetëdrejtuar: Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të artikulojnë qartë konceptin dhe karakteristikat e të mësuarit të vetëdrejtuar.
- Identifikoni përfitimet e të mësuarit të vetëdrejtuar: Pjesëmarrësit do të njohin avantazhet dhe rezultatet pozitive që lidhen me mësimin e vetëdrejtuar për studentët.
- Zbatoni strategji për të promovuar mësimin e vetëdrejtuar: Pjesëmarrësit do të përvetësojnë teknika dhe qasje praktike për të nxitur mësimin e vetëdrejtuar midis studentëve të tyre.
- Dizajnoni mjedise mësimore me në qendër nxënësin: Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të krijojnë mjedise mësimore që lehtësojnë dhe mbështesin mësimin e vetëdrejtuar.
- Përdorni teknologjinë për mësimin e vetëdrejtuar: Pjesëmarrësit do të eksplorojnë dhe përdorin mjete të përshtatshme teknologjike për të përmirësuar përvojat e të mësuarit të vetëdrejtuar për studentët.
- Vlerësoni dhe jepni komente për të mësuarit e vetëdrejtuar: Pjesëmarrësit do të zhvillojnë metoda efektive vlerësimi dhe strategji reagimi të përshtatura për kontekstet e të mësuarit të vetëdrejtuar.
- Mbështetni studentët në mësimin e vetëdrejtuar: Pjesëmarrësit do të fitojnë strategji për të udhëhequr, mentoruar dhe mbështetur në mënyrë efektive studentët në procesin e tyre mësimor të vetëdrejtuar.